



Republika e Kosovës  
Republika Kosova-Republic of Kosovo  
Komuna e Drenasit  
Municipality Drenas  
Zyra e Kryetarit



Nr. 12-030-793, dt. 04.01.2018


**Për:** Ministrinë e Administimit të Pushtetit Lokal, Prishtinë

**Nga:** Kryetari i Komunës së Drenasit, Ramiz Lladrovci



**Lënda:** Dërgimi i akteve të miratuara nga Kuvendi i Komunës së Drenasit në mbledhjen e mbajtur më dt. 27.12.2017

1. Vendim i Komitetit për Politikë dhe Financa
2. Vendim i Komitetit për Komunitete
3. Vendim i Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi



REPUBLIKA E KOSOVËS  
Komuna e Drenasit (Glllogoc)  
Kuvendi i Komunës

Nr. 030-01125 dt. 05/01 .2018



Në bazë të nenit 12 dhe 40 si dhe nenit 53 të Ligjit nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, nenit 4, 8, 10 dhe nenit 13 të udhëzimit administrativ nr.03/2014, nenit 34.6 shkronja g të Statutit të Komunës së Drenasit. Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur më dt. 27.12.2017 mori këtë:

VENDIM

Neni 1

Për themelimin e Komitetit të Komuniteteve të Kuvendit të Komunës së Drenasit si komitet i përhershëm i cili përbehet prej 9(nëntë) anëtarëve si :

1. Bekim Lestrani
2. Kimete Bardhi
3. Malësore Cakiqi
4. Arigon Sinani
5. Vehbi Berisha
6. Mehdi Kastrati
7. Kristina Sopi
8. Murat Bajraktari
9. Jetmira Morina

Neni 2

Komiteti për Komunitete i Kuvendit të Komunës zgjidhet për një mandat 4 vjeçar

Neni 3


Komiteti për Komunitete është përgjegjës për shqyrtimin e të gjitha çështjeve të parapara ne nenin 53.2 të Ligjit nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, si dhe nenit 8 të udhëzimit administrativ nr.03/2014 për procedurën e themelimit, përbërjen dhe kompetencat e komiteve të përhershme në komunë.


Neni 4

Mandati i anëtarëve të komitetit për komunitete perfundon me perfundimin e mandatit të anëtarëve të Kuvendit të Komunës

Neni 5

Ky Vendim hyn në fuqi nga dita e Miratimit nga Kuvendi i Komunës dhe vlerësimi të ligjshmerisë nga MAPL-ja 15 dite pas regjistrimit në zyren e protokollit të ministrit për përgjegjësi për vetëqeverisje Lokale si dhe publikimi në Ueb faqen zyrtare të Komunës.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës  
  
Labinot Halilaj





**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
**Komuna e Drenasit (Glllogocit)**  
Kuvendi i Komunës



12 Nr. 030 - 786 dt 04.01.2018

Në vështrim të nenit 12 dhe 40.2 germa (e) të Ligjit mbi Vetëqeverisjen Lokale, nenit 3.2 të Udhëzimit Administrativ Nr.27/2012 MPB-03/2012 MAPL për Këshillat Komunal për Siguri në Bashkësi dhe nenit 34.6 të Statutit të Komunës së Drenasit, Kuvendi i Komunës së Drenasit, në mbledhjen e mbajtur me dt:27.12.2017, mori këtë:

**V E N D I M**

**MBI THEMELIMIN E KËSHILLIT KOMUNAL PËR SIGURI NË BASHKËSI**

I. THEMELOHET Këshilli Komunal për Siguri në Bashkësi në Komunën e Drenasit në këtë përbërje:

- Ramiz Lladrovci, Kryetari i Komunës (Kryesues),
- Rinore Zymeri, Koordinator e KKS-së,
- Driton Morina, Komandanti i Stacionit të Policisë në Drenas,
- Valon Bequku, Përfaqësuesi i Bashkësisë Islame,
- Alban Sopi, Përfaqësuesi i Komunitetit Katolik
- Tafil Halilaj, Drejtor i Drejtorisë për Arsim,
- \_\_\_\_\_, Kryetari i Këshillit të Prindërve të Arsimit
- Milaim Musliu, një përfaqësues i FSK-së,
- Arben Nika, Ekipi Veprues për Siguri në Bashkësi,
- Lumnije Krap, Një përfaqësues nga Sektori i Emergjencave Civile Komunale,
- Afije Veseli, Përfaqësuesi i Zyrës Komunale për Komunitete dhe Kthim,
- Kadire Tahiraj, Një përfaqësues nga OJQ-të.
- \_\_\_\_\_, Kryesuesi i Komitetit për Komunitete,
- Haxhi Lladrovci, përfaqësues nga biznesi.
- Lavdie Krasniqi, përfaqësues nga mediat lokale
- Taibe Mulaj , përfaqësues nga kom. i personave me aftësi të kufizuara.
- Rina Shabani , Përfaqësuese nga Këshilli i veprimit Rinor Lokal (KVRL)

II. Detyrat dhe përgjegjësit e KKS-së janë të parapara me nenin 6 të Udhëzimit Administrativ nr.27/2012 MBP-03/2012 MAPL për Këshillat Komunale për Siguri në Bashkësi.

III. KKS-ja është organ këshillues për çështjet e sigurisë në bashkësi me përfaqësim të gjerë të të gjitha komuniteteve të komunës dhe përfaqësuesit të shoqërisë civile ndërsa sugjerimet dhe rekomandimet e KKS-së, mund të merren si rekomandime për veprime të Organeve të Komunës.

IV. Kryesues i KKS-së është Kryetari i Komunës në vështrim të nenit 7.3 të Ligjit Nr.04/076 për Policinë ndërsa detyrat dhe përgjegjësit e Kryesuesit janë të përcaktuara me nenin 9 të Udhëzimit Administrativ nr.27/2012MPB-03/2012 MAPL për Këshillat Komunal për Siguri në Bashkësi. Detyrat dhe përgjegjësit e KKS-së janë të përcaktuara me dispozitat e nenit 6 të Udhëzimit Administrativ të cituar më lartë.

V. Anëtarët e KKS-së kanë mandat 4(kater) vjeçar të njëjtë me anëtarët e Kuvendit të Komunës

VI. Me këtë Vendim do të njoftohen Anëtarët e Këshillit dhe një mbetet për evidencë.

VII. Ky Vendim hyn në fuqi nga dita e Miratimit nga Kuvendi i Komunës dhe vlerësimit të ligjshmerisë nga MAPL-ja 15 dite pas regjistrimit në zyrën e protokollit të ministrisë përgjegjëse për vetëqeverisje Lokale si dhe publikimi në Ueb faqen zyrtare të Komunës.





**Republika e Kosovës  
Komuna e Drenasit (Glllogoc)**

**Kuvendi i Komunës**  
12 Nr. 030-793 dt. 04.01.2018



Nga : Kryesuesi i Kuvendit të Komunës- z.Labinot Halilaj

Për: Kryetarin e Komunës z.Ramiz Lladrovci

**LËNDA:** Dërgimi i akteve të miratuara nga Kuvendi i Komunës së Drenasit në mbledhjen e mbajtur më dt : 27.12.2017

1. Vendim i Komitetit për Politik dhe Financa
2. Vendim i Komitetit për Komunitete
3. Vendim i Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi

Drenas,  
04.01.2018